



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0474**  
**Data e Vendimit: 17.07.2023**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenit 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 dhe nenit 64 të Rregullores Nr.002/2022 për Prokurim Publik pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik OE Malsijaj Company Sh.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me numër të prokurimit 616-22-11453-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 17/07/2023, mori këtë:

### **Vendim**

Hedhet si e jashtafatshme, ankesa e "Malsijaj Company" Sh.P.K. me nr. të protokollit 2023/0474 e datës 07/07/2023, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me numër të prokurimit 616-22-11453-2-1-1, inicuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK).

I lejohet, Autoritetit Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale”, me numër të prokurimit 616-22-11453-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*-Faktet dhe rrethanat procedurale-*

Me 13.06.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me numër të prokurimit 616-22-11453-2-1-1.

Me 19.06.2023, OE “Malsijaj Company” Sh.P.K kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 26.06.2023 AK e kishte kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të palejuar.

Operatori ekonomik i pakënaqur me vendimin e AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit, përmes sistemit e-prokurimit me datën 07.07.2023.

*- Administrimi dhe Vlerësimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me numër të prokurimit 616-22-11453-2-1-1, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK), ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me 13.06.2023. Ndaj këtij njoftimi është paraqitur kërkesë për rishqyrtim nga operatori ekonomik ankues me datën 19.06.2023 ndërsa me datën 26.06.2023 AK ka refuzuar kërkesë për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues si të pabazuar.

Meqënëse vendimi I cituar si më sipër i AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës ishte publikuar me 26.06.2023, afati ligjor për të paraqitur ankesë në OSHP ka filluar të rrjedh për nakuesin nga data 27.06.2023 deri me datën 06.07.2023 ora 16:00.

Zyra për pranimin e ankesave pas pranimit të ankesës ka konstatuar se operatori ekonomik ankues OE “Malsijaj Company” Sh.P.K ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 07.07.2023 që rrjedhimisht I bie jasht afatit ligjor të paraparë me LPP. Ankuesi ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 2 të nenit 109 të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtror ankesë në OSHP pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK.

Neni 109 paragrafi 2 i LPP-së përcakton se: *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.* Po ashtu, edhe neni 64.1 në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcaktohen se: *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.*

*-Përfundimi-*

Mbi bazën e të lartëcekurave konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 07.07.2023 nga OE “Malsijaj Company “Sh.P.K për aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale është e jashtafatshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesën brenda afateve ligjore sipas këshillës së dhënë nga ana e Autoritetit Kontraktues. Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Si përfundim ankesë është parashtruar në kundërshtim me nenin 109 të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenit 64 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, si e tillë hedhet si e jashtafatshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Autoritetit kontraktues –Kuvendi i Komunës së Prishtinës, mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Paneli Shqyrtues megjithatë i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Lidhur me tarifën ankimore vendoset në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, që operatorit ekonomik ankues ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - MALSIAJ COMPANY SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: